

VENDIM
Nr.237, datë 3.10.2011

PËR ZGJERIM ZONE LICENCIMI PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR “APT”
SUBJEKTIT PERSON FIZIK: ELTION THANASI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin e KKRT-së, nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit, personit fizik z.Eltion Thanasi, për zgjerim zone licencimi dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televisionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit, person fizik, Eltion Thanasi, licencuar për subjektin televiziv privat kabllor “APT”, sipas licencës nr.039/RTV kabllor, në qytetin e Himarës.
 2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
 3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati